



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.526/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Kastriot Sylja me venbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet i pabazuar** apeli i paraqitur nga **Kastriot Sylja me venbanim në Zvicër**, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

### A r s y e t i m

Me datën 23.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Kastriot Sylja me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se shkak i apelit është refuzimi apo mos përmbyshja e kushteve për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës ashtu që i njëjti fillimisht ka dërguar formularin e mbushur të datës 14 shkurt pastaj ka dërguar formularin e plotësuar për zgjedhjet e 17 shkurt 2021 dhe ka kërkuar që të shqyrtohet edhe njëherë dokumentacioni i tij.

Parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

Me datë 24.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me vendimin me të cilin janë refuzuar aplikuesit dhe arsyetimin e refuzimit të tyre si dhe komunikimin zyrtar të shkruar në mes të KQZ-së dhe aplikuesve nga momenti i aplikimit deri në konfirmimin e pranimit të vendimit/njoftimit të KQZ-së për mos përfshirjen e tyre në listën e votuesve jashtë vendit.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka bashkangjitur edhe tabelën rreth ankesave në të cilën ka theksuar se Kastriot Sylja ka dërguar aplikacionin për regjistrim që është përdorur për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës, ka dërguar aplikacionin për regjistrim që është përdorur për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021 andaj edhe nuk i ka plotësuar kriteret të cilat kërkohen në bazë nenit 5.1 pika a) të LZP-së ku përcaktohet: *“çdo person ka të drejtë për të votuar nëse është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil të Kosovës”*, si dhe dispozita e nenit 3.1 të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror civil”*.

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se parashtruesi i apelit në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës dosja e tij nuk ka qenë e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet

me dispozitat e nenit 5.1 pika a) të LZP-së dhe të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 526/2021 më datën 25.08.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.